



KUVENDI KOMITETI PËR KOMUNITETE

EKSTRAKT

nga procesverbali i mbajtur më 8 shkurt 2011, në mbledhjen e X (dhjetë) të Komitetit për Komunitete.

Mbledhja u mbajt në sallën e mbledhjeve nr. 31 dhe filloi në orën 11.00.

Mbledhjen e hapi z. Shaban Ahmeti, kryesues i Komitetit.

Fillimisht u vërtetua se në mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e këtij Komiteti, përkatësisht z. Burhan Blakçori, z. Nebih Behluli, z. Arbresha Hetemaj , z. Radisav Peroviq , z. Jahë Lahu dhe z. Selver Rama.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë dhe vendimmarrje.

Në mbledhje ishin të pranishëm edhe të ftuarit z. Fadil Babatinca, Stacioni i policisë në Podujevë - Njësi për komunitete, z. Habil Sylejmani, Komanda Rajonale Kufitare Veriu – Lluzhan, z. Mefail Mustafa, OSBE – Zyra rajonale në Prishtinë-Ekipi për komunitete, z. J. Kunstar, LMT – KFOR.

1. Miratimi i rendit të ditës

z. Jahë Lahu, propozoi që pika e katërt e rendit të ditës ku thuhet komunitetit REA të riformulohet, komunitete rom dhe ashkalinj, meqë në Komunën e Podujevës nuk ka egjiptas.

Rendi i propozuar i ditës u miratua njëzëri me korrigjimin e paraqitur.

2. Shqyrtimi dhe miratimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 31 janar 2011

Ekstrakti i procesverbalit u miratua njëzëri.

3. Raportet e KFOR-it dhe Policisë së Kosovës - Stacionit të policisë në Podujevë për nivelin e marrëdhënieve ndëretnike dhe situatën e sigurisë në përgjithësi në Komunën e Podujevës.

z. J. Kunstar, theskoi, situata e sigurisë është e qetë dhe pa probleme të theksuara dhe shtoi gjatë monitorimit të forcave të KFOR-it në brezin kufitar nuk kemi hasur në aktivitete kriminale përveç prerjes ilegale të pyllit.

z. Habil Sylejmani, theskoi, nga aspekti i Policisë kufitare situata e sigurisë vlerësohet e qetë dhe shtoi në pikën kufitare në Merdar kohë më parë është zënë një sasi e drogës në një autobus me linjë ndërkombëtare si dhe ka prerje ilegale të pyjeve.

Përndryshe kemi bashkëpunim në nivel mjaft të lartë si me KFOR-in ashtu edhe me të gjitha subjektet tjera relevante.

z. Fadil Babatinca, nënvizoi, pajtohem me parafolësit se situata e sigurisë është e qetë dhe lirshëm mund të themi se është e shkëlqyeshme.

Në cilësinë e pjesëtarit të Stacionit të policisë në Podujevë kam bindjen e thellë se marrëdhëniet ndëretnike në komunën tonë janë në nivelin më të lartë e kjo është arritur në sja të bashkëpunimit të ndërsjellë të të gjitha institucioneve komunale duke përfshirë edhe ato të Nivelit qendror por edhe OJQ-të.

z. Nebih Behluli, u pajtua me parafolësit për situatën e qetë të sigurisë dhe marrëdhëniet e shkëlqyeshme ndëretnike dhe shtoi, në një mbledhje të mëhershme e kam përmend se ne jemi model për komunat tjera sa i përket marrëdhënieve ndëretnike por edhe punës së këtij Komiteti dhe uroj që kjo të vazhdojë edhe në të ardhmen.

z. Arbresha Hetemaj, theksoi, sigurisht të gjithëve na gëzon fakti për marrëdhëniet e mira ndëretnike ashtu edhe për situatën e qetë të sigurisë, mirëpo sa i përket kësaj të fundit mua më intereson të dijë se çfarë është duke u ndërmarrë për vendosjen e të sëmurëve mental në institucione përkatëse meqë ata paraqesin rrezik të vazhdueshëm, në veçanti për fëmijë, siç ka qenë i rrezikuar fëmiju im kur para derës së shtëpisë është sulmuar me thikë nga një i sëmur mental.

z. Fadil Babatinca, theksoi, policia ka bërë planin operativ për ndërprerjen e dukurisë të lypjes në rrugë, aksion i cili ka rezultuar i suksesshëm, mirëpo për çështjen të cilën e ngriti parafolësja, policia nuk është përgjegjëse ngase ka raste të shumta që personat e sëmurë mental janë dërguar në Klinikën e Neuropsikiatrisë dhe të njëjtit janë kthyer me konstatim se nuk janë të rrezikshëm për rrethin. Përndryshe ky është problem që i shqetëson të gjithë qytetarët dhe kërkon angazhim më të madh në radhë të parë të Qendrës për punë sociale por edhe të të gjitha subjekteve tjera relevante.

z. Burhan Blakçori, nënvizoi, jam shumë i kënaqur që nga raportet e paraqitura vërtetohet se siguria është në nivel dhe marrëdhëniet ndëretnike janë shumë të mira, andaj uroj që situata e këtillë të vazhdojë edhe në të ardhmen.

Sa i përket çështjes të të sëmurëve mental konsideroj se Institucionet kompetente janë të obliguara që këtë problem ta trajtojnë mbi bazën e procedurave të parapara ligjore.

z. Fadil Babatinca, theksoi, Stacioni i policisë në Podujevë ka bashkëpunim të mirëfilltë me të gjitha institucionet relevante por edhe me të gjithë qytetarët, dhe është i hapur dhe gjithëherë ka gatishmëri të plotë për çdo kërkesë të qytetarëve, andaj i ftoj anëtarët e këtij Komiteti por edhe të gjithë të tjerët që për çfarëdo qoftë, në kuadër të kompetencave tona, të mos na kurseni.

Mbi bazën e punës dhe angazhimit, Stacioni i policisë në Podujevë, është shpallur Stacioni i policisë më i miri në Republikën e Kosovës.

z. Mefail Mustafa, theksoi, në dhjetor 2010 në fshatin Metergofc gjatë prerjes së pyllit në mënyrë ilegale ka ndodhur një incident i vogël ku ka pasur edhe kërcënim, lidhur me këtë policia ka qenë në vendin e ngjarjes, andaj më intereson të dijë se rasti konkret në çfarë faze të procedurës është.

z. Fadil Babatinca, parafolësin e njoftoi se rasti i cekur nuk konsiderohet eksens ndëretnik, ndërsa lënda përkatëse është në procedurë në Gjykatën kompetente.

z. Radisav Peroviq, theksoi, për ne banorët e lagjes së sekiraqëve në fshatin Metergofc dy vitet e fundit shqetësimet tona më të mëdha janë lidhur me pengesat për kalimin e vijës kufitare të të afërmeve që na vijnë në vizita, lidhur me këtë vitin e kaluar ky Komitet i ka dërguar një shkresë Kabinetit të Kryeministrit – Zyrës për komunitete, andaj jam i interesuar të dijë se a është marrë përgjigje për shkresën e cekur.

Lidhur me çështjen e shtruar kohën e fundit nuk kemi pasur asnjë problem, ashtu siç nuk kemi pasur problem kur kohë më parë ceremonia e varrimit për një të vdekur ka kaluar pa asnjë problem, mirëpo ne vazhdimisht frikohemi se në të ardhmen mund të ketë ndonjë problem.

Një shtëpi në lagje ka mbetur e zbrazët ngase i biri e ka marrë nënën e vet dhe e ka dërguar në Beograd por ajo shtëpi pas disa ditëve që ka mbetur pa askend është vjedhur dhe porsa është vërejtur kjo është lajmëruar policia të cilën unë shumë e falënderoj për shpejtësinë e ardhjes në vendin e ngjarjes.

z. Habil Sylejmani, nënvizoi, zotëriu Rasha Peroviqi është i njoftuar se për çdo ceremoni apo ritual fetar paraprakisht duhet të bëhet kërkesa me emrat dhe mbiemrat e pjesëmarrësve të interesuar dhe t'i dërgohet Drejtorisë së Policisë kufitare regjionale dhe nëse veprohet në këtë mënyrë në asnjë rast nuk do të ketë kurrfarë problemesh.

z. Radisav Peroviq, theksoi, është rreth i ngushtë i njerëzve që janë të lidhur me atë vend dhe shtoi, derisa patrullimet i ka bërë Policia ndërkombëtare askush nuk ka pasur problem nëse ka thënë se jam duke shkuar te Rasha, mirëpo tash krejt varet prej vullnetit të mirë të policit.

Dua të them edhe këtë se djali im punon në Rusi, prej atje udhëton 3.500 km. dhe për distancën 500 m. nga vija kufitare që e kemi shtëpinë, për të mos pasur probleme detyrohet të udhëtoj edhe 200 km.

z. Burhan Blakçori, theksoi, më vjen mirë që Radisavi thotë se kohëve të fundit nuk kanë pasur probleme personat të cilët kanë ardhur në vizitë në atë lagje dhe shtoi lidhur me këtë çështje ky Komitet në formë të shkruar i është drejtuar Kabinetit të Kryeministrit por sa unë kam informacione nuk kemi marrë përgjigje. Po vërehet se në këtë aspekt ka lëvizje pozitive, këtë e sqaroi shumë mirë z. Habil Sylejmani i cili paraqiti gatishmërinë e Policisë kufitare për ofrimin e ndihmës së mundshme me kusht që paraprakisht të bëhet kërkesa me të dhënat e nevojshme, mirëpo ne gjithsesi duhet të kemi parasysh se policia është e obliguar të zbatoj ligjin.

z. Radisav Peroviq, nënvizoi, në atë lagje jetojnë 7 persona të komunitetit serb, 5 prej tyre janë invalid të cilët kanë nevojë që t'i vizitojnë të afërmit e tyre, mirëpo edhe pse shtëpitë i kanë shumë afër vijës kufitare të afërmit e tyre hezitojnë të vijnë në vizita për shkak të frikës se do të arrestohen nga policia.

Gjithashtu dua të ceku se me këtë problem përballet edhe një familje e cila i ka 200 trupa kumbulla të cilat duhet të mirëmbahen por edhe të mblidhen frytet, ndërsa një rast tjetër kur babai i katër fëmijëve të vegjël kur ka ardhur për t'i vjelë mollët ka hasur në polici e cila e ka dërguar në Llužhan.

z. Habil Sylejmani, lidhur me çështjen e fundit të cilën e përmendi parafolësi, theksoi, kur policia e ka kuptuar se personi në fjalë është banorë i Kosovës me kërkesë të tij është përcjellë në pikën kufitare.

z. Fadil Babatinca, theksoi, kam biseduar me Rashen (Radisavin) dhe në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve të Brendshme kemi shkuar në lagjen e sekiraqëve dhe të gjithë të interesuarve ju kemi mundësuar të pajisen me letërnjoftime në mënyrë që të lëvizin lirshëm, mirëpo edhe në të ardhmen të gjithë të interesuarit mund të pajisen me letërnjoftime të Kosovës në mënyrë që të vërtetojnë identitetin e tyre dhe do të mund të lëvizin pa kurrfarë problemi.

z. Shaban Ahmeti, nënvizoi, ka tetë vite që jam në Komitetin për Komunitete dhe mund të them se në vazhdimësi jemi përpjekur t'ju ofrojmë ndihmën e mundshme banorëve në lagjen e sekiraqëve të cilët kryesisht janë pleq, mirëpo më së tepërmi na gëzon fakti se situata e sigurisë është në nivel.

4. Caktimi i bartësve për përgatitjen e të dhënave statistikore për fëmijët e komuniteteve rom dhe ashkalinj të cilët vijnë në mësimet në shkollimin fillor dhe të mesëm dhe fëmijëve të cilët e kanë braktisur shkollimin në nivelet e cekura.

z. Jahë Lahu, vullnetarisht mori përsipër që të përgatitë të dhënat e cekura.

5. Të ndryshme

z. Jahë Lahu, theksoi, në Republikën e Kosovës do të bëhet regjistrimi i popullsisë, lidhur me këtë do të ngritën komisione të ndryshme dhe propozoi që në ato komisione të përfshihen edhe pjesëtarë të komunitetit rom dhe ashkalinj. Më 15 shkurt, vazhdoi ky diskutues, është Dita e ashkalinjve dhe u interesua të dijë se a do të mbahet ndonjë manifestim për shënimin e kësaj dite.

Kryesuesi z. Shaban Ahmeti, parafolësit iu përgjigj se para dy viteve, për shënimin e Ditës së ashkalinjve ka ndihmuar OSBE, mirëpo sa unë kam informacione këtë vit nuk mund të na ndihmojnë ngase nuk kanë mjete financiare për destinime të tilla.

z. Mefail Mustafa, nënvizoi, sipas OSBE-së, Zyra regjionale në Prishtinë, është vlerësuar se Plani i punës për vitin 2011 i Komitetit për Komunitete të Komunës së Podujevës është i detajizuar dhe i shkruar në mënyrë perfekte dhe si plani më i mirë u është dërguar komunave tjera si model se si shkruhet Plani i punës.

Sa i përket shënimit të 15 shkurtit, ditës së ashkalinjve, shtoi ky diskutues OSBE e ka një projekt ideor sipas të cilit parashihet që një grup i nxënësve të takohet me menaxherin e RTK-së dhe të informohen për punën e këtij mediumi informativ.

Mbledhja përfundoi në orën 12,10 .

Procesverbalin e mbajti

Faik Gashi

Nr. 01/24-06

Podujevë,

8 shkurt 2011

**Kryesuesi i Komitetit
Shaban Ahmeti**